LIGJ
Nr. 112/2012

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN SHTESË TË NAGOJA-KUALA LUMPURIT "PËR PËRGJEGJËSI DHE DËMSHPËRBLIM TË PROTOKOLLIT TË KARTAGJENËS PËR BIOSIGURINË" TË KONVENTËS SË BIODIVERSITETIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin shtesë të Nagoja-Kuala Lumpurit "Për përgjegjësi dhe dëmshpërblim të protokollit të Kartagjenës për biosigurinë" të konventës së biodiversitetit, sipas tekstit bashkëlidhur.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.11.2012

Shpallur me dekretin nr. 7858, datë 11.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani